



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Bordi i Administrimit

Nr. 4206 prot.

Shkodër, më 28.12.2018

V E N D I M

Nr. 481 datë 26.12.2018

**"PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019"**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 49, 112, ligjin nr.10296, dt.08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), Ligjit nr.109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018", VKM-së nr.269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive te individeve që plotësojnë kriteret e pranimit një një program të ciklit të parë të studimeve, që përjashtohen tarifat vjetore e shkollimit" pika 1 e 2, relacionit të administratorit nr.4155 datë 24.12.2018, bordi i administrimit në mbledhjen e tij të datës 26.12.2018,

**Vendosi:**

1. Miratimin e listës së studentëve të ciklit të parë që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2018-2019 në programet e studimit të ciklit të parë për kategoritë sipas përcaktimeve të pikës 1 të VKM -së nr. 269, datë 29.03.2017 (bashkëlidhur materiali).
2. Ngarkohet Administratori i USH-së për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**EDUARD NDRECA**

